



Nr. 47 pikt
Dt. 16/12/2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr.35, datë 15/12/2022

PËR

SHFUQIZIMIN E LEJES NR. 8, DATË 26.07.2011 “PËR PËRDORIMIN E REZERVAVE UJORE PËR PRODHIM ENERGJIE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASENIT UJOR DRIN-BUNË, NR. 8, DATË 26.07.2011 “PËR MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË REZERVËS UJORE PËR PRODHIM HIDROENERGJIE”

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të V.K.M Nr.550, datë 15.7.2020 "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit të vendimmarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Zyres së Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë

V E N D O S I:

1. Shfuqizimin e Lejes Nr.8, datë 26.07.2011 “Për Përdorimin e Rezervave Ujore Për Prodhim Energjie”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Basenit Ujor Drin-Bunë, nr. 8, datë 26.07.2011 “Për miratimin e Lejes për Përdorim të Rezervës Ujore për Prodhim Hidroenergjie”, subjektit “SHALA ENERGY” SH.P.K, me objekt “HEC THETHI”.
2. Ngarkohet Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

MAJLINDA ANGONI

